



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 08.12.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58. b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/ L-040, Përfundimit nr.06-85343-7/2 të miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve me dt:03.12.2015 dhe nenit 19.1 të Rregullores së Ministrisë së Financave nr.02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, me dt: 08.12.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për inventarizimin e pasurisë e Drejtorisë për Arsim dhe institucioneve parashkollore dhe shkollore të cilat menaxhohen nga kjo drejtori, në këtë përbërje:

1. Afijete Efendija, kryesuese e Komisionit
2. Afijete Boshjanku, anëtare
3. Ali Uka, anëtar

2. Përgjegjësitë e Komisionit të përshkruar në pikën paraprake janë:

- Inventarizimi i të gjithë pasurisë të cilën e kontrollon organizata buxhetore - Drejtoria për Arsim dhe institucioneve parashkollore dhe shkollore të cilat menaxhohen nga kjo drejtori;
- Identifikimi i pasurisë që nuk ka vlerë të bartur;
- Identifikimi i pasurisë së dëmtuar dhe jashtë përdorimit;
- Përgatitja e raportit për kryerjen e inventarizimit dhe dorëzimi i këtij raporti në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa;

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të Komisionit
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Arsim
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila